



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 74

Prill

2011

Vendim i GJL
nr.1, datë 26.11.2010

Me objekt kundërshtimin e aktit administrativ, vendimit
nr.3550, datë 30.10.2009, për prishje objekti..... 3

VENDIM
Nr.1, datë 26.11.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Ardian Dvorani	Kryesues
Besnik Imeraj	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Aleksandër Muskaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Majlinda Andrea	anëtare
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 26.11.2010 morën në shqyrtim çështjen civile që i përket:

PADITËS: Qamil Muça, i biri i Bajramit, i datëlindjes 1937, lindur e banues në Tiranë, në rrugën “Kongresi i Manastirit” nr.93, përfaqësuar nga avokati Basri Mana.

I PADITUR: Inspektorati Ndërtimor dhe Urbanistik Pranë Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga juristët Natasha Kondi dhe Parid Sinella.

OBJEKTI: Kundërshtim i aktit administrativ, vendimit nr.3550, datë 30.10.2009, për prishje objekti.

Baza ligjore: Neni 324, 328, 202 të Kodi i Procedurës Civile, neni 117 i Kodit të Procedurave Administrative.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.10267, datë 9.12.2009, ka vendosur:

Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes civile nr.14369 Akti, me palë paditëse: Qamil Muça dhe palë e paditur Inspektorati Ndërtimor dhe Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranës.

Kundër vendimit nr.10267, datë 9.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar ankim të veçantë paditësi Qamil Muça, i cili kërkon prishjen e këtij vendimi dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes, duke parashtruar këto shkaqe:

- Banesa 2-katëshe nuk është prona ime, megjithëse nga ana e Inspektoratit vendimi për prishje është nxjerrë në emër të paditësit, duke e konsideruar banesën në fjalë një ndërtim të kryer pa lejen e organeve kompetente.

- Në momentin që është mbajtur procesverbali nga ana e palës së paditur janë kërkuar dokumentacioni i pronësisë së banesës, por duke qenë se nuk i kam pasur në moment iu kam kërkuar për të aplikuar në ZVRPP Tiranë për t'i marrë. Mirëpo pala e paditur nuk ka pritur, por ka marrë vendim për prishjen e banesës.

- Kjo banesë është ndërtuar në mesin e viteve 40 dhe është e trashëguar dhe se është e regjistruar sipas sistemeve të regjistrimit në fuqi në momentin kur është ndërtuar.

- Vendimi i nxjerrë për prishjen e banesës është nxjerrë jo në emrin e pronarit, por të dikujt tjetër, duke e bërë atë të pavlefshëm.

- Duke mos qenë dakord me vendimin nr.3550, datë 30.10.2009 “Për prishjen e objektit”, i jam drejtuar gjykatës për kundërshtimin e këtij akti administrativ, por që nga ana e kësaj gjykate, në seancën përgatitore e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor me arsyetimin se nuk është ndjekur rruga e ankimit administrativ.

- Gjykata për marrjen e vendimit është mbështetur në nenet 4 dhe 14/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007, mirëpo ky është interpretim i gabuar, pasi ligji nuk ka bërë një përcaktim të tillë, por shprehet se kundër një vendimi të tillë mund të bëhet ankim administrativ dhe gjyqësor. Pra kjo dispozitë nuk lë të kuptohet se duhet të shterojë ankimi administrativ, pastaj bëhet ankimi në gjykatë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 16.2.2010, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të unifikuar praktikën gjyqësore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

Pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Medi Bici dhe Ardian Dvorani; mbrojtjen e përfaqësuesit të paditësit Qamil Muça, avokatin Basri Mane, që kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit; mbrojtjen e përfaqësuesve të palës së paditur, juristët Natasha Kondi dhe Parid Sinella, që kërkuan lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, që ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi nr.10267, datë 9.12.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit procedural civil. Prandaj ky vendim duhet të prishet dhe çështja t'i dërgohet po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit, sepse bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

Nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë deri në këtë fazë të gjykimit, rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Pala e paditur, Inspektorati Ndërtimor dhe Urbanistik pranë Bashkisë Tiranë, bazuar në kontrollin e ushtruar në datën 26.10.2009 dhe procesverbalin e mbajtur po në atë datë për këtë qëllim, ka vlerësuar se nga ana e palës paditëse Qamil Muça është realizuar një ndërtim pa leje, një banesë dykatëshe e ndodhur në rrugën "Kongresi i Manastirit", nr.93 në qytetin e Tiranës.

Mbështetur në të dhënat e kontrollit dhe komunikimin paraprak me paditësin, pala e paditur ka nxjerrë vendimin nr.3550, datë 30.10.2009, me të cilin urdhërohet prishja e ndërtimit pa leje të sipërcituar të realizuar nga pala paditëse Muça.

Në rrethana të tilla, duke pretenduar se bëhet fjalë për një banesë të vjetër dhe të ndërtuar me miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas legjislacionit që ka qenë në fuqi në kohën e ndërtimit, pala paditëse Qamil Muça i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkak ligjor dhe objekt padie kundërshtimin e aktit administrativ, vendimit nr.3550, datë 30.10.2009, të nxjerrë nga i padituri Inspektorati Ndërtimor dhe Urbanistik pranë Bashkisë Tiranë për prishjen e banesës së ndërtuar nga ana e paditësit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pala e paditur i ka kërkuar gjykatës të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, për shkak se paditësi nuk ka ndjekur paraprakisht rrugën e detyrueshme administrative të ankimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka çmuar se kërkesa e palës së paditur është e mbështetur në ligj dhe ka vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes.

Në thelb, gjykata arsyeton se, në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar më parë ankimin në rrugën administrative. Edhe ligji i posaçëm i zbatueshëm për çështjen objekt gjykimi, ligji nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", në nenin 14/1 të tij, parashikon se kundër vendimeve të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë, komunës apo të qarkut, për marrjen e masave dhe dhënien e sanksioneve përkatëse lejohet ankim administrativ dhe gjyqësor sipas dispozitave në fuqi. Sipas nenit 4 të po atij ligji, inspektoratet janë ngritur pranë njësive vendore përkatëse. Prandaj, vijon arsyetimi i kësaj gjykate, subjekti ndaj të cilit është nxjerrë akti administrativ i inspektoratit ndërtimor dhe urbanistik vendor duhet t'i drejtohet me ankim administrativ organit epror të tij, kryetarit të njësisë vendore përkatëse. Në çështjen objekt gjykimi, përpara se të kundërshtonte aktin administrativ në gjykatë, paditësi duhet t'i ishte drejtuar paraprakisht me ankim administrativ, organit epror të palës së paditur, Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë pala paditëse Qamil Muça, me anë të të cilit kërkon prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit. Ndërmjet të tjerave, paditësi pretendon se gjykata ka interpretuar e zbatuar në mënyrë të gabuar nenet 4 dhe 14/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit". Këto dispozita vetëm indikojnë se kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik mund të bëhet ankim administrativ dhe gjyqësor, por pa u shprehur se ndjekja paraprakisht e rrugës administrative të ankimit është e detyrueshme për subjektin ndaj të cilit është dhënë akti administrativ.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 16.2.2010, ka çmuar se është vendi për të kaluar çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për unifikim dhe njësim të praktikës gjyqësore. Kolegji ka vendosur në këtë mënyrë duke çmuar rëndësinë thelbësore që luan përcaktimi i juridiksionit gjyqësor mbi mundësinë dhe efektivitetin e ushtrimit të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese e ligjore, përfshirë ato të rehabilitimit e zhdëmtimit nga akte të paligjshme të organeve shtetërore, si dhe duke konstatuar që në praktikën gjyqësore janë mbajtur qëndrime të kundërta në të gjitha shkallët e gjykimit.

Kolegjeve të Bashkuara u janë parashtruar për shqyrtim sa vijon:

“ 1. A është e detyrueshme ndjekja paraprake e rrugës administrative të ankimit kundër vendimeve të dhëna nga inspektoratet vendore ndërtimore e urbanistike sipas dispozitës së nenit 14 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”?

2. Nëse po, cili është organi administrativ ku, sipas këtij ligji të posaçëm, duhet të drejtohet ankimi administrativ kundër vendimit të dhënë nga inspektorati vendor ndërtimor dhe urbanistik?

Pasi shqyrtuan çështjen, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i gjejnë të mbështetura në ligj pretendimet e parashtruara në ankimin e veçantë të paditësit Muça për zbatim të gabuar nga gjykata e shkallës së parë të ligjit procedural përsa i përket përcaktimit të juridiksionit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Për rrjedhojë, vendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë për nxjerrjen e çështjes objekt gjykimi jashtë juridiksionit gjyqësor është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit procedural, ndaj duhet të prishet dhe të vazhdojë shqyrtimi i çështjes, sepse ajo bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

Kolegjet e Bashkuara vërejnë se në praktikën gjyqësore të të gjitha shkallëve të gjykimit, janë mbajtur qëndrime të ndryshme e të kundërta në lidhje me ekzistencën e juridiksionit administrativ apo të atij gjyqësor për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me objekt kundërshtimin e akteve administrative të nxjerra nga inspektoratet vendore urbanistike e ndërtimore për prishjen e ndërtimeve të realizuara nga subjektet e ndryshme, bazuar në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Në dispozitën e nenit 14 të këtij ligji parashikohet se:

“Kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e masave dhe dhënien e sanksioneve administrative lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi. Ankimi administrativ dhe gjyqësor kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Kundër vendimeve të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar lejohet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar nuk pezullon ekzekutimin e tij”.

Sipas njërës qëndrim, dispozita e sipërcituar e nenit 14 nuk i njeh subjektit të drejtën e zgjedhjes ndërmjet rrugës administrative dhe asaj gjyqësore për të kundërshtuar aktin administrativ. Nisur nga dispozita e nenit 137 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se *“në parim palët e interesuara mund t'iu drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ”*, si dhe nisur nga parimet e tjera të procedimit administrativ të parashikuara nga ky Kod, është e detyrueshme ndjekja paraprakisht e rrugës administrative të ankimit ndaj vendimeve të inspektorateve vendore urbanistike e ndërtimore të nxjerra sipas ligjit nr.9780, datë 16.7.2007.

Sipas qëndrimit tjetër, në lidhje me aktet e nxjerra nga inspektoratet urbanistike vendore, ligji vetëm shprehet në mënyrë deklarative se *“... lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor...”*, por pa përcaktuar në mënyrë të detyrueshme ndjekjen paraprake të rrugës administrative të ankimit dhe as se cili do të ishte organi administrativ më i lartë ku do të duhej të drejtohej ky ankimi. Gjithashtu, në interpretim të nenit 137 të Kodit të Procedurave Administrative, pala e interesuar nuk mund t'iu drejtohet juridiksionit gjyqësor vetëm nëse ligji i posaçëm ka parashikuar shprehimisht detyrimin dhe ka treguar konkretisht rrugën për ndjekjen dhe ezaurimin e rekursit administrativ. Pra, rrugë të detyrueshme administrative të ankimit ka vetëm nëse ligji i posaçëm ka parashikuar në mënyrë të shprehur, si mjet efektiv ankimi, detyrimin për ndjekjen e rrugës administrative të ankimit, organin apo organet administrative konkrete të ngarkuara shprehimisht nga ligji i posaçëm me pranimin për shqyrtim të ankimit dhe kompetencën e tyre për t'iu shprehur në mënyrë ezauruese lidhur me ankimin administrativ.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se për përcaktimin e juridiksionit të detyrueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi dhe për unifikimin e praktikës gjyqësore, krahas interpretimit dhe zbatimit të drejtë të dispozitave përkatëse të posaçme, janë të njëvlefshme edhe kuptimi e zbatimi i drejtë i parimeve dhe normave kushtetuese e ligjore të përgjithshme mbi detyrueshmërinë ose jo të ndjekjes së rrugës administrative të ankimit ndaj akteve administrative në tërësi. Kështu, përveç të tjerave, janë të zbatueshme parimet e të drejtat themelore kushtetuese, si dhe kriteret e procedurat ligjore mbi funksionimin, sjelljen dhe ushtrimin e kompetencave nga administrata publike (si pjesë të pushtetit ekzekutiv), në tërësi dhe në fusha të veçanta, raportet ndërmjet këtyre hallkave dhe individëve e subjekteve juridike përsa i përket shqyrtimit të çështjeve, kërkesave e ankesave që u janë parashtruar prej tyre, si dhe mbi të drejtën e detyrimit e gjykatave në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

Kushtetuta, në dispozitën e nenit 4 të saj, sanksionon *parimin themeltar të shtetit të së drejtës*, ku shprehet se “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit...”.

Ndërsa në nenin 7 sanksionohet edhe *parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve*: “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”.

Në harmoni me parimet e mësipërme kushtetuese, dispozitat vijuese të Kushtetutës, përfshirë edhe ato të neneve 15 e 42 të saj, sanksionojnë edhe *parimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së administratës publike dhe të drejtën e ankimit administrativ e gjyqësor të individit e subjekteve juridike*. Kështu, dispozita e nenit 42 parashikon se “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë....., ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Parimi i shtetit të së drejtës, mes të tjerave, kërkon që të garantohet mbrojtja e plotë e individit dhe personave juridikë kundrejt cenimit të sferës së të drejtave të tyre nga ndërhyrjet e pushtetit publik. Kjo mbrojtje përfshin edhe parashikimin e qartë nga ligji të rregullave të sjelljes së administratës publike dhe individëve, të së drejtës (por edhe detyrimit) së këtyre të fundit për të kërkuar realizimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme, si dhe për t’u ankuar me mjete efektive nëse këto të drejta u cenohen apo u kufizohen pa respektuar ligjin dhe në mënyrë të paarsyeshme.

Nga ana tjetër, në një shtet të së drejtës, kompetencat, të drejtat e detyrimit e hallkave të administratës publike duhet të jenë të përcaktuara me ligj. Organet publike nuk mund të ushtrojnë, sipas diskrecionit të tyre, kompetenca që nuk ua njih shprehimisht ligji, veçanërisht nëse ushtrimi i tyre lidhet me çështje që kanë të bëjnë me kërkesa dhe ankesa të individëve e personave juridikë lidhur me pretendime për cenimin e të drejtave e interesave të tyre të ligjshme.

Pikërisht për këtë qëllim, në respektim të parimit të ligjshmërisë së veprimtarisë së administratës publike, ligji duhet të përmbajë norma që rregullojnë në mënyrë konkrete e në hollësi veprimtarinë e administratës publike pa u mjaftuar e kufizuar në formulime dispozitash me natyrë të përgjithshme a deklarative. Një dispozitë e përgjithshme dhe e paqartë, aq më tepër me natyrë deklarative, bën që të mbetet në diskrecionin e organit administrativ përcaktimi i sjelljes dhe kompetencës së tij në raport me individët dhe personat juridikë. Për rrjedhojë, në këndvështrimin e kundërt, bën që ky diskrecion të vendosë edhe kufizime në lirinë e ushtrimit të të drejtave themelore të njeriut, në mënyrë të paarsyeshme e të paparashikuar nga ligji. Një kuadër i tillë rregullues juridik dhe një sjellje e tillë e autoritetit publik, nuk pajtohet me parimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së administratës publike.

Nga ana tjetër, kemi të bëjmë me cenim të parimit të ndarjes së pushteteve, nëse sjelljet, autorizimet dhe kompetencat e organeve të administratës publike (si pjesë të pushtetit ekzekutiv) nuk janë parashikuar fare, apo nuk janë të përcaktuara në mënyrë konkrete, të qartë dhe ezauruese. Në të tilla rrethana, edhe në këndvështrim të nenit 118 të Kushtetutës, veprimtaria dhe sjellja e autoritetit publik ekzekutiv nuk është e nuk ushtrohet në bazë e për zbatim të ligjit, këto autoritete nuk veprojnë sipas urdhërimeve të pushtetit legjislativ, por vendosin vetë në vend të tij.

Së fundi, Kushtetuta u ka ngarkuar gjykatave misionin e mbrojtjes, garantimit dhe respektimit të këtyre parimeve themeltare kushtetuese dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut. Ky mision i gjykatave mund të realizohet vetëm atëherë kur zbatimi i ligjit nga hallkat e pushtetit ekzekutiv, nëse ato ndërhyjnë në sferën e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut, është i kontrollueshëm nga gjykatat.

Kontrolli gjyqësor dhe, anasjellas, e drejta e individëve dhe personave juridikë për t’iu drejtuar gjykatës, lidhet jo vetëm me ekzistencën e parimeve të përgjithshme, por edhe me përcaktimin e qartë e konkret, të treguar shprehimisht në ligjet e posaçme, të rrethanave, kushteve e procedurave konkrete për

investimin e mundshëm a të detyrueshëm të juridiksionit administrativ dhe, në çdo rast, të juridiksionit gjyqësor, për pranimin, marrjen në shqyrtim dhe dhënien e vendimit përkatës mbi një mosmarrëveshje, mbi një kërkesë apo ankesë të të interesuarve që ka për subjekt realizimin a mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre.

Sipas nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile në juridiksionin gjyqësor hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile që parashikohen në kodet dhe ligjet përkatëse. Asnjë institucion tjetër nuk mund të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u shqyrtuar nga gjykata. Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera.

Kur një çështje hyn në juridiksionin e gjykatës, nuk mund të shqyrtohet njëkohësisht edhe nga një organ i administratës publike (juridiksioni administrativ) dhe anasjelltas. Ky përfundim rezulton qartazi, veç të tjerave, nga përmbajtja e nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile.

Parimet nga të cilat udhëhiqet legjislacioni në fuqi që rregullon veprimtarinë e administratës publike parashikon se organet administrative dhe veprimtaria e tyre i nënshtrohen rrugës dhe mjeteve të kontrollit, ku përfshihen edhe kontrolli administrativ dhe ai gjyqësor. Ky kontroll i shërben ecursionit normale të veprimtarisë administrative dhe mbi të gjitha përbën një garanci për moscenimin e të drejtave të individëve dhe të subjekteve juridike.

Një nga format e kontrollit administrativ është ajo e ankimit administrativ, si një mjet juridik i rëndësishëm për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individëve dhe subjekteve juridike.

Sikurse parashtrohet edhe më sipër në këtë vendim, e drejta e ankimit është një parim i rëndësishëm kushtetues që buron nga nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës (e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe e drejta për rehabilitim e zhdëmtim ndaj veprimit a mosveprimit të paligjshëm të administratës publike). Po kështu, edhe KEDNJ në nenin 13 parashikon shprehimisht të drejtën e kujtdo për të bërë një ankim efektiv ndaj shkeljeve të kryera nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve zyrtare.

Prandaj, Kodi i Procedurave Administrative parashikon parimet e përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese e ligjore të subjekteve nëpërmjet nënshtimit të veprimtarisë administrative ndaj kontrollit të brendshëm administrativ (krahas atij gjyqësor). Ky Kod, në nenet 9, 14, 15, 18, 135, 137, 140, 146, etj., përmban edhe parime të përgjithshme mbi ankimin administrativ, efektet e tij ligjore, procedurat e shqyrtimit, afatet përkatëse, etj. Po kështu, edhe ligjet e veçanta parashikojnë rregulla të veçanta mbi ushtrimin e të drejtës së ankimit administrativ mbi afatet e procedurat përkatëse të posaçme, sipas natyrës përkatëse të mosmarrëveshjes administrative.

Kolegjet e Bashkuara evidentojnë se e drejta jonë e së drejtës publike (Kodi i Procedurave Administrative) njeh ushtrimin e ankimit administrativ nëpërmjet apelimit administrativ dhe kërkesës joformale. Qëllimi dhe dallimi ndërmjet këtyre mjeteve të ankimit ndikon në përcaktimin e juridiksionit që i shqyrton ato, në procedurat, rrugën dhe radhën e detyrueshme të investimit të juridiksionit administrativ e atij gjyqësor.

Ndërkohë që Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, edhe për shkak të rasteve të formulimit të paqartë të dispozitës ligjore, në praktikën gjyqësore konstatohen qëndrime konfuzë dhe kundërshti në interpretimin e këtyre mjeteve të ankimit administrativ, veçanërisht për sa i përket përcaktimit të juridiksionit të detyrueshëm gjyqësor apo administrativ për shqyrtimin e tyre.

Ushtrimi i ankimit administrativ nëpërmjet kërkesës joformale, nuk përbën një rrugë administrative të detyrueshme të subjektit për t'u ankuar, por një të drejtë të tij për ta paraqitur atë kërkesë, duke pasur parasysh se organi administrativ që i kërkohet të shqyrtojë këtë lloj ankimi, mund ta zgjidhë atë vetëm nëse një kompetencë të tillë ia ka njohur shprehimisht ligji. Në rastet e kërkesës joformale, duke mbetur një opsion, një mundësi që ligji i njeh individit për t'i paraqitur organit administrativ pretendimin e tij, gjykata nuk ka pengesë të investohet direkt për ta marrë atë në shqyrtim.

Ndërsa apelimi administrativ, si një mjet juridik i plotë për të kërkuar shfuqizimin a ndryshimin e aktit administrativ, përbën një mjet ankimi me natyrë shteruese dhe njëkohësisht të detyrueshme për t'u ezauruar me qëllim që më pas t'i drejtohesh gjykatës. Apelimi administrativ kërkon respektimin e disa kushteve formale, pa të cilat nuk mund të pretendohet të kryhet një proces i rregullt administrativ. Nga njëra anë, kushte formale janë ato të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, por edhe në ligje të veçanta. Ndërkohë që, e drejta dhe detyrimi i subjektit për të paraqitur apelim administrativ, respektivisht, e drejta dhe detyrimi i organit konkret administrativ për ta marrë atë në shqyrtim, si formë ankimi administrativ me efekt shterues, duhet të jenë parashikuar konkretisht dhe shprehimisht në ligjet e posaçme që rregullojnë fushat e veçanta të veprimtarisë administrative.

Prandaj, edhe në respektim të parimit të ndarjes së pushteteve, ligjet e posaçme të nxjerra për rregullimin e marrëdhënieve juridike në fusha të veçanta, si rregull, por gjithsesi në mënyrë konkrete e të shprehur, parashikojnë investimin e detyrueshëm të të dy juridiksioneve, atij administrativ dhe gjyqësor në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve mes një organi të administratës publike dhe subjekteve të së drejtës, në lidhje me aktin administrativ të nxjerrë nga organi publik.

Akoma më tej, duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe parimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së administratës publike dhe atij të shtetit të së drejtës, është ligji që parashikon dhe tregon, në mënyrë të shprehur e konkrete, se zgjidhja e mosmarrëveshjes bën pjesë në juridiksionin administrativ dhe, në mbarim të shqyrtimit administrativ, mosmarrëveshja zgjidhet në mënyrë përfundimtare nga gjykata.

Nisur nga sa arsyetohet më sipër, Kolegjet e Bashkuara konfirmojnë edhe një herë jurisprudencën e konsoliduar se e drejta e ankimit dhe kërkit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes administrative në rrugën (juridiksionin) administrativ dhe në atë gjyqësore është një e drejtë kushtetuese. Kështu, në *vendimin unifikues nr.3, datë 12.2.2008*, në të cilin trajtohen aspekte të së drejtës dhe detyrimeve reciproke të subjekteve tatimore dhe organeve për të ushtruar apelim administrativ dhe për marrjen në shqyrtim të tyre, Kolegjet e Bashkuara, ndër të tjera, janë shprehur se: “35. Në vështrim të legjislacionit në fuqi, nenit 6, 13 të Konventës për të drejtat e njeriut, neneve 17, 41, 42 të Kushtetutës, si dhe qëndrimeve interpretuese të Gjykatës Kushtetuese, janë gjykatat e zakonshme ato që shqyrtojnë zbatueshmërinë e parimeve të procesit të rregullt ligjor nga ana e administratës shtetërore, si në nxjerrjen e aktit administrativ, ashtu dhe gjatë procedurës të kundërshtimit të këtij akti në rrugë administrative e të kundërshtuar në një gjykim individual (akte të karakterit individual dhe jonormativ – të përgjithshëm për ato që nuk janë penguar nga neni 325 i Kodit të Procedurës Civile për t’u kundërshtuar në gjykatë)”.

Kështu që, edhe në rastin e investimit të të dy juridiksioneve, atij administrativ dhe gjyqësor, ky investim për shqyrtimin e ankimit mbi mosmarrëveshjen administrative, jo vetëm nuk është dhe nuk mund të jetë i njëkohshëm, por as edhe në diskrecionin e organit administrativ apo të individëve e subjekteve ankimuese, për të zgjedhur njërën prej këtyre juridiksioneve. Kështu që, vetëm ligji, në mënyrë të shprehur, mund të përcaktojë si rrugë të detyrueshme ndjekjen dhe ezaurimin e rrugës administrative të ankimit nëpërmjet apelimit administrativ, përpara se individi a subjekti juridik t’i drejtohet gjykatës me anë të padisë përkatëse.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, në kushtet kur e drejta e ankimit në rrugën (juridiksionin) administrative dhe në atë gjyqësore është një e drejtë kushtetuese, nëse dispozita konkrete të ligjeve të veçanta parashikojnë thjesht se subjekti ka të drejtën për të ushtruar ankim administrativ dhe padi në gjykatë ndaj një akti administrativ, ndodhemi përpara një norme me natyrë deklarative dhe afirmuese të vetë parimeve e të normës kushtetuese. Një dispozitë ligjore e formuluar në mënyrë të tillë nuk krijon një mjet efektiv ankimi a kërkimi për subjektin, si dhe nuk tregon konkretisht që rruga administrative e ankimit ose apelimit administrativ është një rrugë e detyrueshme për t’u ezauruar paraprakisht në mosmarrëveshjet administrative të fushës përkatëse. Aq më tepër kur nuk është treguar as organi konkret administrativ ku duhet të paraqitet ankimi dhe kompetenca përkatëse e tij për të pranuar e vendosur mbi atë ankim.

Prandaj, në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit në fushën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve administrative në tërësi, ku përfshihet edhe dispozita e nenit 14 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “*Për inspektimin e ndërtimit*”, i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimet unifikuese si vijon:

Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t’i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ.

Përveç detyrueshmërisë së parashikimit të ndjekjes së rrugës administrative të ankimit, të organit ku ai drejtohet dhe që ka kompetencën për shqyrtimin e saj, eventualisht, sipas natyrës së marrëdhënieve juridike dhe asaj të mosmarrëveshjes, ligji i posaçëm mund të parashikojë ose jo edhe modalitete konkrete mbi afatet, kushtet e procedurat që duhen respektuar për të bërë të pranueshëm

për shqyrtim në themel ankimin administrativ, për procedurat e shqyrtimit dhe natyrën e vendimmarrjes nga organi administrative, etj. Nëse rregulla të tilla eventuale nuk janë parashikuar, gjejnë zbatim afatet, kushtet e procedurat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

Kjo mënyrë e shprehjes së vullnetit të ligjvënësit, nga njëra anë autorizon dhe legjitimon organin administrativ të pranojë, marrë në shqyrtim dhe vendosë lidhur me ankimin administrativ. Nga ana tjetër, jo vetëm i detyron të ndjekin rrugën administrative për efekt të respektimit të uniformitetit të veprimtarisë administrative dhe sigurisë juridike, por, mbi të gjitha i garanton individëve dhe subjekteve të tjerë një proces të rregullt ligjor dhe një mjet efektiv juridik, pasi pretendimi i tyre për cenimin e një të drejte a interesi kushtetues dhe ligjor detyrimisht do të merret në shqyrtim dhe do të zgjidhet nga organi administrativ.

Në çdo rast, pavarësisht nëse parashikohet apo jo shprehimisht në ligjin e posaçëm, pas dhënies së vendimit nga organi a organet administrative të ngarkuar nga ligji, pala që kishte ushtruar ankimin administrativ ka të drejtën t'i drejtohet rrugës gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative. Nëse ligji i posaçëm nuk parashikon shprehimisht ndryshe, zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara për këtë qëllim nga Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurave Administrative.

Edhe përsa i përket interpretimit dhe zbatimit të drejtë të dispozitave të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, posaçërisht të dispozitës së nenit 14 të këtij ligji, nuk është e detyrueshme ndjekja e rrugës administrative të ankimit nga ana e individëve dhe e personave juridikë, ndaj të cilëve inspektorati ndërtimor e urbanistik vendor ka nxjerrë një vendim për marrje masash dhe dhënie sanksionesh administrative. Kjo dispozitë, përsa i përket ushtrimit të së drejtës për ankim administrativ dhe padi në rrugë gjyqësore, mbetet një normë me karakter thjesht deklarativ, duke mos treguar detyrueshmërinë e ndjekjes paraprake të rrugës administrative të ankimit, si dhe organet kompetente të ngarkuara me detyrimin për pranimin për shqyrtim dhe dhënien e vendimit përkatës”.

Dispozita e nenit 14 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” vetëm sa deklaron që: *“kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut.... lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi”.* Njëkohësisht, parashikime të shprehura për detyrueshmërinë e ndjekjes së rrugës administrative të ankimit dhe mbi organin përkatës kompetent për shqyrtimin e ankimit nuk përmbahen edhe në asnjë dispozitë tjetër e këtij ligji”.

Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit e përfundimet unifikuese të lartpërmendura, pretendimet e parashtruara në ankimin e veçantë të paditësit Muça janë të mbështetura në ligj. Prandaj, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, që ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, me arsyetimin se paditësi nuk ka ezauruar paraprakisht rrugën administrative të ankimit, duhet të prishet dhe çështja t'i dërgohet po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit të çështjes, pasi ajo bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë” dhe të nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

1. Prishjen e vendimit nr.10267, datë 9.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.
 2. Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.
 3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njëson praktikën gjyqësore.
- Anëtar pro: Adrian Dvorani, (kryesues), Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Andi Çeliku, Aleksandër Muskaj, Ardian Nuni, Guxim Zenelaj, Evelina Qirjako, Arjana Fullani, Mirela Fana, Majlinda Andrea.
Anëtar kundër: Medi Bici

MENDIM I PAKICËS

Unë gjyqtari në pakicë, Medi Bici, në bazë të nenit 307/2 të Kodit të Procedurës Civile, parashtrij me shkrim mendimin tim kundër për t'ia bashkangjitur vendimit nr.1, datë 26.11.2010 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Paditësi Qamil Muça i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar kundërshtimin e aktit administrativ të nxjerrë nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik, pranë Bashkisë Tiranë, me të cilin është vendosur prishja e banesës në pronësi të tij.

Pas kërkesës që ka bërë në gjyq pala e paditur, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë Tiranë, për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.10267, datë 9.12.2009 ka vendosur:

Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

Mbi bazën e ankimit të veçantë të bërë nga paditësi Qamil Muça, çështja ka ardhur për t'u gjykuar në Gjykatën e Lartë dhe Kolegji Civil i kësaj gjykatë me vendimin e datës 16.2.2010 ka vendosur:

Dërgimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara për të njësuar praktikën gjyqësore, pasi nga gjykatat janë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me këtë çështje.

Kolegji Civil shtron për zgjidhje para Kolegjeve të Bashkuara problemet e mëposhtme:

A është e detyrueshme ndjekja paraprake e rrugës administrative të ankimit kundër vendimeve të dhëna nga inspektoratet vendore ndërtimore e urbanistike, sipas dispozitës së nenit 14 të ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit"?

Nëse po, cili është organi administrativ kundër vendimit të dhënë nga inspektorati ndërtimor dhe urbanistik?

Ashtu si shumica, edhe unë jam i mendimit që në rastin objekt gjykimi ka ekzistuar nevoja për unifikimin e praktikës gjyqësore, por me mënyrën se si është unifikuar ajo nuk jam dakord.

Në nenin 14/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" (të ndryshuar), është parashikuar ankimi administrativ dhe gjyqësor, ku thuhet:

"Kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e masave dhe sanksioneve administrative lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi....."

Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në përfundimin që, meqenëse kjo dispozitë nuk parashikon shprehimisht organin që i drejtohet ankimi administrativ dhe afatet e ankimit, atëherë ajo mbetet një dispozitë deklarative dhe pala që ka ankim duhet t'i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës.

Në vlerësimin tim, ky përfundim në të cilin kanë arritur Kolegjet e Bashkuara është i gabuar, sepse Gjykata e Lartë nuk mund të unifikojë praktikën gjyqësore duke marrë kompetencat e organeve të tjera, siç janë legjislativi, Gjykata Kushtetuese dhe pushteti vendor.

Duke vendosur në këtë mënyrë, Gjykata nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka shfuqizuar pjesërisht nenin 14 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit".

Titulli i kësaj dispozite, pas marrjes së vendimit nga gjykata, bëhet ankimi gjyqësor dhe në dy paragrafët e parë të saj hiqen fjalët ankimi administrativ.

Vlerësimi im është që unifikimi i praktikës gjyqësore bëhet vetëm nëpërmjet interpretimit të ligjit në kuptimin e gjerë dhe të ngushtë të tij, ose duke përdorur katër format e interpretimit të tij (literale, historike, logjike dhe gjuhësore), por asnjëherë nuk duhet të deformohet vullneti i ligjvënësit.

Është detyrë e gjykatës që, gjatë interpretimit të ligjit të nxjerrë në pah atë që ka dashur të thotë në të vërtetë ligjvënësi dhe cili ka qenë vullneti i tij, dhe jo të thuhet që dispozita është deklarative, duke e lënë pa fuqi atë.

Nga citimi i nenit 14 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007, del qartë që vullneti i ligjvënësit në këtë rast ka qenë që pala e interesuar të ndjekë rrugën administrative dhe gjyqësore të ankimit.

Në praktikë ka pasur keqkuptime në lidhje me dualizmin e juridiksionit dhe pretendohet që i interesuari mund të zgjedhë midis juridiksionit administrativ dhe atij gjyqësor.

Ky qëndrim është i gabuar, sepse juridiksioni është një i vetëm dhe ai ose i përket administrativit, ose gjyqësorit dhe jo të dy organeve në të njëjtën kohë.

Në nenin 137/3 të Kodit të Procedurave Administrative, thuhet:

Në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ.

Ky është rregulli i përgjithshëm dhe përjashtimin nga rregulli nuk e bën gjykata, por vetëm ligji, siç ka ndodhur me nenin 14/3 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007, në rastin e ankimit ndaj vendimeve të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

Në këtë rast ligji e lejon palën e interesuar që, pa ndjekur rrugën administrative të ankimit, t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës, brenda një afati 10- ditor.

Në pjesën arsyetuese të vendimit shumica i mëshon faktit që cenohen parimet e ligjshmërisë dhe të ankimit efektiv, por me qëndrimin që ka mbajtur ka shkelur dy parime të tjera shumë të rëndësishme të së drejtës administrative, të cilat janë parimi i subsidiaritetit dhe parimi i kontrollit të brendshëm administrativ.

Me ligjin nr.8548, datë 11.11.1999, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka ratifikuar Kartën Europiane të Autonomisë Vendore.

Sipas kësaj Karte, parimi bazë në qeverisjen vendore është parimi i subsidiaritetit, që do të thotë shërbimet publike të shkojnë sa më afër komunitetit.

Nuk mendoj që zgjidhja e çështjes nga gjykata në rastin e ankimit të një vendimi të inspektoratit ndërtimor të një komune, ose bashkie shumë të largët nga qendra e rrethit gjyqësor do të ishte zgjidhja më efiçente, kur kjo çështje mund të merrte një zgjidhje përfundimtare në komunën, ose bashkinë përkatëse.

Kontrolli i brendshëm administrativ, i cili bëhet nga vetë organi administrative është po aq i rëndësishëm sa kontrolli i jashtëm, i cili bëhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (për çështjet që lidhen me financat) dhe gjykatat.

Parimi i kontrollit të brendshëm administrativ, i parashikuar nga neni 18 i Kodit të Procedurave Administrative, është një parim shumë i rëndësishëm, sepse me anë të këtij kontrolli organet më të larta të administratës kontrollojnë dhe njohin me hollësi veprimtarinë e vartësve të tyre.

Nuk mund të thuhet që ankimi administrativ është më pak efektiv se sa ai gjyqësor, sepse dhe punonjësit e administratës, në marrjen e vendimeve të tyre, janë të detyruar që të zbatojnë parimin e drejtësisë dhe të paanësisë, të parashikuar nga neni 12 i Kodit të Procedurave Administrative.

Vlerësimi im është që Kolegjet e Bashkuara nuk duhet ta anashkalojnë kurrësi rrugën administrative të ankimit, por ato duhet ta orientonin praktikën gjyqësore se kush është organi ku duhej drejtuar ky ankim.

Për të dhënë mendimin tim në lidhje me këtë çështje, më vjen në ndihmë neni 4/3 i ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", i cili thotë:

"Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë/komunës."

Sipas kësaj dispozite, titullari i inspektoratit ndërtimor emërohet nga kryetari i bashkisë/komunës, pra është vartës direkt i tij, prandaj ankimi administrativ i duhet drejtuar pikërisht kryetarit të bashkisë ose të komunës.

Ndërsa për afatet e ankimit, vetë neni 14/1 i ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 përdor shprehjen: "afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi."

Kjo do të thotë që, për afatet e ankimit palët e interesuara janë të detyruara që të zbatojnë afatet e përgjithshme, të cilat parashikohen në Kodin e Procedurave Administrative.

Duke arsyetuar si më sipër, vlerësoj që vendimi nr.10267, datë 9.12.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i bazuar në ligj dhe për rrjedhojë duhej të lihej në fuqi, prandaj vota ime është kundër vendimit nr.1, datë 26.11.2010 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Anëtar: Medi Bici

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 20.4.2011
Doli nga shtypi më 22.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 12 lekë